

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des Nations
Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

Legjislatura e –III-

KOMISIONI PARLAMENTAR PËR BUJQËSI, PYLLTARI,
ZHVILLIM RURAL, MJEDIS DHE PLANIFIKIM
HAPËSINOR

Procesverbal Nr. 1
nga mbledhja e mbajtur më **12.2.2008**
kryesuar nga **Lulzim Zeneli**-kryetar i komisionit
Mbledhja filloi në orën 12,00

Të pranishëm :

- | | |
|-------------|-----------------|
| 1. Lulzim | Zeneli |
| 2. Ibrahim | Selmanaj |
| 3. Zylfi | Merxha |
| 4. Berat | Luzha |
| 5. Elheme | Hetemi |
| 6. Ali | Lajçi |
| 7. Zef | Morina |
| 8. Heset | Cakolli |
| 9. Selvie | Halimi |
| 10. Myrvete | Pantina |
| 11. Kosara | Nikolić |

PJESËMARRËSIT TJERË : Blerim Vela nga OSBE etj

RENDI I DITËS U MIRATUA PA VËREJTJE :

1. Mbledhje konstituive e komisionit.

1. **Lidhur me pikën e parë** kryesuesi **Lulzim Zeneli**-kryetar, përshëndeti të pranishmit-anëtarët e komisionit duke ju dëshiruar sukses në këtë mandat. Ai shkurtimisht njoftoi me përgjegjësit e këtij komisioni në fushën e Bujqësisë dhe të Mjedisit , dhe konstatoi se në këtë komision tani janë tri anëtarë nga mandati i kaluar (kryetari, Berat Luzha dhe Selvie Halimi) të cilët padyshim do të kontribuojnë në zgjedhjen e çështjeve të ndryshme që do të paraqiten në punën e këtij komisioni. Ai theksoi se ky komision është i njohur për nga kompaktësia në punë e cila gjithnjë është bazuar në kooperim të ngushtë. Plani i punës së komisionit, vazhdoi ai, do të bazohet në njoftimet nga dy ministritë përkatëse lidhur me programin e punës së tyre, të cilat do të monitorohen nga ky komision parlamentar. Ai në vazhdim përveç që i sqaroi edhe ca detale për punën e komisionit, për çka edhe nga stafi ka kërkuar një shkresë sqaruese për punën e komisionit në mandatin e kaluar, konstatoi se kjo mbledhje e sotme është më tepër e karakterit njohës, ndaj sugjeroi që secili anëtarë të prezantohet, por fillimisht para kësaj, ai njoftoi anëtarët e komisionit për punën urgjente që duhet ta bëjë Kuvendi lidhur me miratimin e buxhetit të sivjetmë, për çka kryetari i Kuvendit dje i ka ftuar kryetarët e komisioneve të japin sugjerimet eventuale për secilin komision veç e veç.

Zylfi Merxha përshëndeti komisionin dhe ju dëshiroj sukses anëtarëve në këtë mandat, gjë të cilin e bënë edhe anëtarët tjerë : **Zef Morina, Berat Luzha, Elheme Hetemi, Ali Lajçi, Myrvete Pantina, Kosara Nikoliq, Heset Cakolli dhe Selvie Halimi.** Përveç që theksuan rëndësinë e fushveprimtarisë së këtij komisioni, anëtarët e cekur kërkuan monitorim dhe rritje të buxhetit për dy ministritë përkatëse, për çka Myrvete Pantina (anëtare edhe në komisionin për buxhet) theksoi se këto dy ditë do të punohet shumë në këtë drejtim për shkak të materialeve voluminoze, dhe në fund do të shihet se sa mund të realizohen kërkesat nga ky takim. Kryetarit të komisionit të gjithë i uruan sukses.

Lulzim Zeneli falënderoi , ndërsa nga përfaqësuesi i OSBE-së kërkoi të sqaroi lidhur me përgatitjet që ka bërë kjo organizatë për një takim me këtë komision, i cili takim do të jetë në favor të deputetëve të rinj, të cilët do të njoftohen më përafërsisht për fushën e Mjedisit dhe të Bujqësisë etj.

Blerim Vela njoftoi fillimisht anëtarët e komisionit se OSBE-ja do të gjendet përkrah aktiviteteve të këtij komisioni dhe do të asistoi në çdo aktivitet të këtij komisioni sikurse në mandatin e kaluar , njëherit rikujtoi për suksesin e plotë të konferencës rajonale për çështje mjedisore , e cila është mbajtur me iniciativën e këtij komisioni përmes asistimit të OSBE-së (ai shpërndau raportin me shkrim lidhur me këtë konferencë). Lidhur me takimin njëditorë që planifikon OSBE (një lloj seminari) me këtë komision, ai u përqendrua në datën 15 shkurt, por kryesuesi dhe disa anëtarë tjerë potencuan se vështirë do të realizohet ky synim, për shkak të punëve voluminoze rreth buxhetit.

Zef Morina kundërshtoi datën 15 për shkak të seancës, ndërsa për dy kërkesat e shpërndara sot (nga APK dhe ZUUR) tha se duhet të shqyrtohen më detalisht nga ky komision, ndaj sugjeroi që ky komision të mbaj edhe një takim para së premtes.

Pas konsultimeve të anëtarëve të komisionit, por edhe me sugjerimin e z. Blerim Vela , komisioni nxori :

P Ë R F U N D I M

1. Formohet grupi 4 anëtarësh e përbërë nga **Ibrahim Selmanaj, Selvije Halimi, Kosara Nikoliq dhe Elheme Hetemi** të cilët do të rishikojnë projektin e buxhetit sa i përket fushveprimtarisë së këtij komisioni dhe do të sugjerojnë komisionit për qëndrimin e mundshëm rreth këtij projekti, sidomos për faktin se a duhet të propozohet ndonjë amendament apo jo.
2. Takimi i radhës i komisionit është ditën e enjte në orën 11,00, lidhur me qëndrimin e komisionit rreth Buxhetit të propozuar.
3. Ky komision, parimisht do të mbaj mbledhjet të marteve në orën 13,00.
4. Takimi me OSBE-në do të mbahet të premtën e ardhshme 22 shkurt, por nëse ka ndryshime prapë do të diskutohet të enjtën. Të bisedohet rreth përmbajtjes së shkresës që do t'ju dërgohet shteteve të rajonit rreth konstituimit të komisionit.

Takimi përfundoi në orën 13,05

Bajram Badivuku z.l.l.

Kryesuesi i Komisionit-kryetari,
Lulzim Zeneli,

